

MIRATOHET

MINISTRI

MYQEREM TAJAJ



STATUTI I UNIVERSITETIT “ALEKSANDËR MOISIU”, DURRËS

Durrës, Maj 2011

KREU I

Dispozita të Përgjithshme

Neni 1

Universiteti “Aleksandër Moisiu”, Durrës është institucion publik i Arsimit të Lartë me karakter mësimor e shkencor. Ai është krijuar me Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 801, datë 20.12.2005 “Për hapjen e Universitetit “Aleksandër Moisiu” Durrës”.

Neni 2

1. Ky Statut mbështetet në Ligjin Nr. 9741, datë 21.05.2007 “Për Arsimin e Lartë në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar si dhe në gjithë legjislacionin tjetër në fuqi.
2. Këtij statuti i nënshtrohen të gjitha njësitë e strukturat organizative dhe mësimore shkencore të Universitetit “Aleksandër Moisiu”, Durrës.

Neni 3

1. Universiteti “Aleksandër Moisiu”, Durrës është person juridik publik i njohur si i tillë nga ligji dhe dispozitat e Kodit Civil.
2. Rektori është autoriteti drejtues, i cili e përfaqëson dhe vepron në emër të këtij institucioni brenda kufijve të të drejtave që i njeh ligji, Statuti, Rregullorja e universitetit dhe akte të tjera ligjore e nënligjore.

Neni 4

1. Struktura akademike e Universitetit “Aleksandër Moisiu”, Durrës përbëhet nga Fakulteti i Biznesit, Fakulteti i Edukimit, Fakulteti i Teknologjise dhe Informacionit, Fakulteti i Shkencave Politiko-Juridike, Fakulteti i Studimeve Profesionale, Fakulteti i Studimeve të Integruara me Praktikën (FASTIP), dhe Filiali në qytetin e Peshkopisë i cili ka statusin e një fakulteti.

2. Këtij Statuti i nënshtrohen të gjitha ndryshimet e mundshme, të strukturës së pikës 1 të këtij neni, të bëra në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi.

Neni 5

Fakultetet në përputhje me legjislacionin në fuqi organizohen në departamente. Hapja, mbyllja, ndryshimi dhe emërtimi i tyre propozohen nga njësitë kryesore përkatëse dhe miratohen në Senatin Akademik sipas standardeve të përcaktuara nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës.

Neni 6

1. Universiteti në përputhje me ligjin Nr. 9741, datë 21.05.2007 “Për Arsimin e Lartë në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar mund të hapë filiale në rrethe të tjera jashtë qytetit të Durrësit.

2. Kriteret për hapjen e filialit janë:

- a) Kërkesë nga autoritetet lokale për hapjen e filialit;
- b) Tregu i punës;
- c) Infrastruktura fizike;
- d) Personeli akademik i kualifikuar;
- e) Kapaciteti ekonomik dhe financiar.

3. Funkcionimi i filialit, struktura dhe organika përcaktohen me rregullore të veçantë miratuar nga Senati Akademik.

Neni 7

Misioni i Universitetit “Aleksandër Moisiu” Durrës

Universiteti “Aleksandër Moisiu”, Durrës në gjithë veprimtarinë e tij synon në mënyrë të vazhdueshme të arrijë standardet akademike më të larta bashkëkohore kombëtare dhe ndërkombëtare, si dhe të përkrahë aspiratat arsimore dhe arrijtet e cilitdo që kërkon të përfitojë nga arsimi i lartë. Me misionin e tij universiteti ka për qëllim nxitjen dhe zhvillimin e të menduarit kritik e analitik, si dhe ndjenjës së përgjegjësisë dhe angazhimit ndaj njeriut, komunitetit, kulturave, ngjarjeve e çështjeve të ndryshme që shqetësojnë individin dhe komunitetin.

Për të realizuar këtë mision strategjik ai u përmbahet këtyre qëllimeve kryesore:

- a) Njëpërmjet programeve universitare mësimore-shkencore të një niveli të përparuar e bashkëkohor teorik, metodik e praktik, të përgatisë profesionalisht specialistë të lartë në fusha që përmbushin nevojat e individëve dhe punëdhënësve duke i përgatitur të diplomuarit për karriera të shumëllojshme në tregun konkurrues të punës në përputhje me kërkesat dhe nevojat e shoqërisë në ndryshim dhe zhvillim;
- b) Njëpërmjet punës kërkimore-shkencore të nivelit më të përparuar të formojë shkencëtarë të rinj në fushat që mbulon;
- c) Njëpërmjet programeve kryen kualifikime shkencore të personelit akademik në të gjitha fushat e shkencave të mirëfillta teorike dhe në fushat e shkencave të zbatuara dhe metodike-administrative që mbulon;
- d) Të tërheqë specialistët më të mirë dhe të inkurajojë me të gjitha mënyrat kontributin e tyre, vazhdimisht në rritje, në fushat përkatëse;
- e) Të kryejë studime shkencore për të zhvilluar më tej dijen në profilet shkencore që lëvron;
- f) Të ofrojë kualifikim të vazhdueshëm e bashkëkohor për personelin akademik në fushat që mbulon;
- g) Njëpërmjet programeve universitare të përgatitë specialistë të profileve të caktuara ose të ngushta për fushat që mbulon ose për fusha të reja që dalin, për t'iu përgjigjur nevojave kombëtare e rajonale;
- h) Studimet universitare zhvillohen në përputhje me rregullat dhe parimet e Hapësirës Evropiane të Arsimit të Lartë. Diplomat ofrohen në dy gjuhë (shqip dhe anglisht) dhe vlerësimi shprehet sipas Sistemit Evropian të Transferimit të Krediteve (ECTS) dhe Sistemit Amerikan të Krediteve, për të krijuar lehtësi lexueshmërie, transferimi dhe vazhdimi të studimeve universitare në universitetet e tjera brenda dhe jashtë vendit.

Neni 8

Liria Akademike dhe Autonomia Institucionale

1. Universiteti “Aleksandër Moisiu”, Durrës gëzon liri dhe autonomi akademike në mësimdhënie, kërkim shkencor dhe autonomi organizative dhe financiare në përputhje me ligjin Nr. 9741, datë 21.05.2007 “Për Arsimin e Lartë në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.
2. Liria akademike shprehet në lirinë e mësimdhënies, lirinë e kërkimit shkencor, lirinë e krijimit në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi dhe parimet e hapësirës evropiane të arsimit të lartë.
3. Në kuadrin e autonomisë organizative dhe financiare Universitetit “Aleksandër Moisiu”, Durrës i njihen këto të drejta:
 - a) E drejta për të organizuar strukturën e brendshme dhe veprimtaritë e saj bazuar në statutin dhe rregulloren;
 - b) E drejta për të caktuar kritere të pranimit të studentëve në programe të studimit;

- c) E drejta për të mbledhur fonde dhe për të përfituar mjete materiale sipas rregullave në fuqi si dhe e drejta për të realizuar marrëveshje të pavarura me Këshillin e Ministrave ose organizma të tjerë për trajnime, kualifikime ose projekte kërkimore, e drejta për të realizuar marrëveshje me institucione, shoqëri biznesi dhe shoqata vendase dhe të huaja, publike ose private etj.;
- d) E drejta e miratimit të Statutit dhe Rregulloreve;
- e) E drejta e miratimit të plotë të planeve e programeve mësimore dhe kërkimore-shkencore në përputhje me misionin e tij strategjik të parashikuar në Nenin 4 të këtij Statuti dhe me Strategjinë Kombëtare të Zhvillimit të Arsimit të Lartë;
- f) E drejta e propozimit për ndryshime në strukturën organizative të universitetit;
- g) E drejta e përcaktimit të kriterëve të përzgjedhjes dhe e përzgjedhjes së personelit akademik dhe joakademik;
- h) E drejta e përcaktimit të fushave dhe programeve të studimit dhe të kërkimit shkencor;
- i) E drejta e organizimit të punës akademike në fushën e mësimdhënies dhe të kërkimit shkencor, brenda strukturave organizative të miratuara me pikësynim parësor realizimin e misionit të tij strategjik parashikuar në nenin 4, të këtij Statuti;
- j) E drejta e personelit akademik për të organizuar punën e tyre profesionale në fushën e mësimdhënies e të kërkimit shkencor në mënyrë të pavarur duke i dhënë përparësi realizimit të detyrave dhe objektivave të parashikuara në misionin strategjik të universitetit në programet mësimore dhe kërkimore-shkencore, në rregulloren e universitetit dhe në vendimet e organeve drejtuese në shkallë institucioni;
- k) E drejta e zgjedhjes së organeve dhe autoriteteve të veta drejtuese në shkallë institucioni, në fakultete e departamente dhe e drejta e emërimit të autoriteteve sipas ligjit Nr. 9741, datë 21.05.2007 “Për Arsimin e Lartë në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, si dhe Rregullores së Zgjedhjeve;
- l) E drejta e personelit të universitetit për t’u zgjedhur e për të zgjedhur organet dhe autoritetet e veta drejtuese sipas legjislacionit në fuqi, për të cilat vë në dijeni dhe Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës;
- m) E drejta e vendosjes së lidhjeve dhe marrëveshjeve me institucione të tjera të arsimit të lartë brenda dhe jashtë vendit për shkëmbim përvoja, për shkëmbim studentësh dhe shkëmbim personeli akademik, për bashkëpunim në procesin mësimor-shkencor si dhe për kualifikimin e personelit akademik, për të cilat vë në dijeni dhe Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës;
- n) E drejta e vendosjes së marrëdhënieve dhe anëtarësimit në shoqata e organizata kombëtare e ndërkombëtare të arsimit të lartë;
- o) E drejta e bashkëveprimit me fondacionet vendase dhe të huaja që ndihmojnë në realizimin e misionit strategjik dhe në përsosjen e universitetit në fushën e mësimdhënies dhe kërkimit shkencor;
- p) E drejta e disponimit të buxhetit vënë në dispozicion nga Buxheti i Shtetit me miratim të Kuvendit të Shqipërisë dhe të ardhurave që siguron universiteti gjatë veprimtarisë së tij ekonomike dhe administrimit të tyre sipas legjislacionit në fuqi;

E drejta e përcaktimit, zë më vete në buxhetin e universitetit, për fonde të veçanta për kërkimin shkencor dhe e drejta e administrimit të këtij fondi nga universiteti në përputhje me dispozitat përkatëse të ligjit Nr. 9741, datë 21.05.2007 “Për Arsimin e Lartë në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar.

- a) E drejta e përcaktimit dhe shpërndarjes së buxhetit për kërkime shkencore njësisive dhe strukturave organizative akademike në shkallë institucioni, fakultete, departamente, seksione departamentesh, qendra kërkimore, grupime ad-hoc të dy ose më shumë anëtarëve të personelit akademik dhe në raste të veçanta një anëtar të vetëm të personelit akademik, si dhe e drejta e administrimit të këtyre fondeve në mënyrë të pavarur nga të gjitha nivelet e përmendura më lartë në përputhje me dispozitat përkatëse të Ligjit të Arsimit të Lartë dhe akteve të tjera nënligjore;
- b) E drejta e zotërimit dhe administrimit të trojeve, ndërtesave dhe pasurive të tjera që zotëron dhe siguron universiteti të dhëna nga shteti, të blera ose të dhuruara sipas ligjeve në fuqi, gjatë veprimtarisë së tij ekonomike;
- c) E drejta e zotërimit dhe administrimit të çdo lloj pasurie tjetër sipas legjislacionit në fuqi;
- d) E drejta e dhënies dhe marrjes së shërbimeve në fushat që kanë lidhje me aspektet e zbatimit praktik të mësimdhënies e të kërkimit shkencor dhe e realizimit të të ardhurave prej tyre në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Neni 9

1. Të gjitha mjediset (ndërtesa e troje) që administron Universiteti “Aleksandër Moisiu”, Durrës si dhe çdo mjedis që në të ardhmen do të zotërohet sipas ligjit, gëzojnë paprekshmërinë.

2. Paprekshmëria e garantuar nga shteti përfshin:

- a) Moslejimin e ndërhyrjes në mjediset e universitetit apo të përdorimit të tyre nga çdo person fizik e juridik (shtetëror e privat) me qëllim përvetësimin e tyre;
- b) Mosndërhyrjen e pushtetit vendor dhe të organeve të rendit publik pa lejen e Rektorit ose të personit të autorizuar prej tij;
- c) Me përjashtim të rasteve të kryerjes së një krimi flagrant dhe në rastet e një fatkeqësie natyrore organet e rendit publik ndërhyjnë edhe pa lejen e Rektorit.

3. Për çdo cënim të paprekshmërisë universitetit i lind e drejta e denoncimit të shkeljes dhe kërkimit të ndëshkimit të shkelësit sipas dispozitave ligjore.

KREU II

Organet dhe Autoritetet Drejtuese të Universitetit “Aleksandër Moisiu”, Durrës

Neni 10

Senati Akademik

1. Senati Akademik i Universitetit “Aleksandër Moisiu”, Durrës është organ vendimmarrës kolegjal, i zgjedhur nga universiteti. Ai vendos për planifikimet strategjike dhe problemet më të rëndësishme të institucionit në fushën e mësimin, të kërkimit shkencor dhe të organizimit administrativ e financiar.

2. Senati Akademik përbëhet nga anëtarë të personelit akademik, personelit jo akademik dhe studentë të cilët zgjidhen drejtpërdrejt nga grupet përkatëse të anëtarëve të institucionit.

- a) Anëtarët e Senatit Akademik, përfaqësues të personelit akademik, zgjidhen me shumicë votash nga fakultetet përkatëse. Çdo fakultet ka të paktën dy përfaqësues minimalisht me gradën shkencore “Doktor”;
- b) Anëtarët e Senatit Akademik, përfaqësues të administratës dhe të studentëve zgjidhen përkatësisht nga administrata dhe studentët sipas një procedure të përcaktuar në Rregulloren e Zgjedhjeve. Përfaqësimi i studentëve duhet të jetë në çdo rast 15% e anëtarëve ndërsa i personelit administrativ jo më pak se 5 %.
- c) Rektori i universitetit është Kryetar i Senatit Akademik.

3. Mandati i anëtarëve të Senatit Akademik është 4-vjeçar. Mandati i anëtarit të Senatit Akademik merr fund:

- a) Me mbarimin e afatit të mandatit;
- b) Kur jep dorëheqjen;
- c) Me shkëputjen e marrëdhënieve të punës me universitetin;
- d) Kur mungon pa arsye në 3 (tre) seanca të njëpasnjëshme mbledhjesh të Senatit Akademik;
- e) Kur dënohet me vendim gjyqësor të formës së prerë.

Në rastet kur mandati i anëtarit të Senatit Akademik merr fund, zëvendësimi i anëtarit të larguar kryhet me anë të zgjedhjeve të reja të shpallura nga Rektori, brenda dy javëve në njësinë që përfaqëson anëtari i larguar.

4. Senati Akademik mblidhet në seanca të zakonshme të paktën dy herë në tre muaj. Rendi i ditës propozohet nga Kryetari i Senatit Akademik dhe miratohet në çdo rast nga Senati Akademik.

- a) Senati Akademik mund të mblidhet edhe në seanca të jashtëzakonshme me një rend të caktuar me nismën e Rektorit ose me kërkesë me shkrim nga 50 % e anëtarëve;
- b) Mbledhja e Senatit Akademik zhvillohet kur janë të pranishëm më shumë se gjysma e anëtarëve të Senatit Akademik dhe drejtohet nga Kryetari i Senatit Akademik. Në raste të veçanta Kryetari i delegon të drejtën e drejtimit të mbledhjes së zakonshme Nënkryetarit;
- c) Vendimet merren me shumicën e thjeshtë të votave (mbi 50%) të anëtarëve të Senatit Akademik të pranishëm në mbledhje;
- d) Për çdo rast Senati Akademik vendos nëse votimi do të jetë i fshehtë apo i hapur. Mënyra e votimit të fshehtë është e detyrueshme në rastin e votimeve nominale, procedurave të klasifikimit të personelit mësimor-shkencor dhe sa herë që kërkohet nga Kryetari ose nga $\frac{1}{4}$ e anëtarëve të Senatit Akademik të pranishëm në mbledhje;
- e) Çdo anëtar e ushtron vetë të drejtën e votës, dhe nuk ka të drejtë ta delegojë atë;
- f) Seancat e Senatit Akademik nuk janë publike, por në to mund të ftohen persona të jashtëm për konsultim. Procesverbalet e seancave të Senatit Akademik bëhen publike

vetëm me vendim të Senatit Akademik. Vendimet e Senatit Akademik janë të detyrueshme për të gjitha strukturat e Universitetit “Aleksandër Moisiu”, Durrës;

g) Mënyra e funksionimit të Senatit Akademik përcaktohet në rregulloren e tij.

5. Senati Akademik me propozim të Kryetarit zgjedh Nënkryetarin dhe Sekretarin, si dhe miraton rregulloren e tij të brendshme me shumicë votash. Rektori, Nënkryetari dhe Sekretari përbëjnë Kryesinë e Senatit Akademik. Kryesia e Senatit Akademik kujdeset për krijimin e infrastrukturës së domosdoshme për mbarëvajtjen dhe funksionimin normal të veprimtarisë së Senatit Akademik.

6. Funksionet e Senatit Akademik:

- a) Përcakton politikën dhe drejtimet e zhvillimit e të perspektivës së universitetit në përputhje me parimet e Procesit të Bolonjës dhe Strategjisë Kombëtare për Zhvillimin e Arsimit;
- b) I paraqet kërkesë Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës për vlerësimin e cilësisë dhe akreditimin e programeve të studimit, qendrave kërkimore-shkencore, departamenteve, fakulteteve apo vetë universitetit;
- c) I propozon Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës hapjen, mbylljen, ndryshimin dhe emërtimin e njësive kryesore (fakulteteve dhe filialeve) dhe programeve të studimit. Pasojat ekonomike përballohen nga universiteti deri në akordimin e buxhetit përkatës;
- d) Vlerëson dhe miraton hapjen e qendrave kërkimore shkencore, të programeve mësimore, si dhe hapjen ndryshimin ose mbylljen e njësive mësimore ose kërkimore;
- e) Përcakton në përputhje me legjislacionin në fuqi drejtimet kryesore të veprimtarisë kërkimore-shkencore, kualifikuese dhe teknike të universitetit;
- f) Në përputhje me legjislacionin në fuqi përcakton kriteret për vlerësimin dhe vendos për dhënien e titujve;
- g) Përcakton drejtimet kryesore të bashkëveprimeve të universitetit dhe njësive kryesore të tij me të tretët;
- h) Miraton dhe dërgon për aprovim në strukturat kompetente projektbuxhetin. Pas miratimit të tij nga organet kompetente miraton ndarjen e (buxhetit) burimeve financiare sipas zërave dhe nënzërave për njësitë përbërëse të universitetit;
- i) Shqyrton dhe miraton projekt Statutin e universitetit me 2/3 e votave të anëtarëve të tij dhe ia përcjell Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës për miratim;
- j) Senati Akademik ratifikon marrëveshjet të cilat më pas nënshkruhen nga Rektori;
- k) Miraton anëtarësimin e institucionit në organizata kombëtare e ndërkombëtare arsimore e shkencore, lidhjet e binjakëzimit me universitete e shkolla të tjera të larta të vendit e të huaja, si dhe marrëveshjet e bashkëpunimit me organizma joqeveritare, donatorë vendas e të huaj që mund të ndihmojnë në zhvillimin e universitetit si dhe çdo marrëveshje që Rektori nënshkruan në emër të universitetit;
- l) Miraton pranimin e donacioneve vendase apo të huaja sipas akteve ligjore e nënligjore në fuqi;

- m) Garanton respektimin e parimeve të autonomisë dhe mundësive të barabarta të lirisë akademike e të kërkimit, si dhe të drejtat e studentëve;
- n) Miraton planin disavjeçar të zhvillimit të institucionit dhe programin vjetor të veprimtarive të tij;
- o) Krijon komisione të përhershme ose të përkohëshme (anëtarët të cilët përfitojnë trajtim financiar pas miratimit në Këshillin e Administrimit) për probleme që i quan të rëndësishme dhe analizon punën e tyre;
- p) Shqyrton dhe miraton propozimin e Këshillit të Profesorëve për dhënien e titujve “Profesor emeritus” dhe “Doctor Honoris Causa”, përkatësisht personelit akademik të universitetit dhe personaliteteve të shkencës, artit, kulturës, politikës dhe ekonomisë, vendas dhe të huaj;
- q) Vendos kriteret për shpërndarjen e bursave nëpër fakultete e qendra të tjera të universitetit;
- r) Në përputhje me nenin 57, pika 3 të ligjit nr. 9741 datë 21.05.2007 “Për Arsimin e Lartë në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, përcakton kriteret e shpërblimit për studentët e shkëlqyer në Universitetin “Aleksandër Moisiu”, Durrës;
- s) Përcakton kriteret e shpërblimit për personelin akademik dhe administrativ ose të një pjese të tij, që është shquar në realizimin e një detyre të caktuar të një rëndësie të veçantë;
- t) Miraton rregulloret e institucionit, që janë në kompetencë të tij;
- u) Vlerëson, garanton dhe mban përgjegjësi për sigurimin e brendshëm të cilësisë në institucion, në përputhje me standartet shtetërore;
- v) Vlerëson veprimtarinë mësimore - kërkimore të personelit akademik;
- w) I kërkon mendim Këshillit të Administrimit për probleme që janë në kompetencë të këtij të fundit.
- x) Miraton raportin vjetor të veprimtarisë mësimore- kërkimore si dhe atë financiar, në një mbledhje të hapur për të gjithë personelin akademik e administrativ dhe për studentët.

Neni 11

Këshilli i Administrimit

1. Këshilli i Administrimit është organ kolegjal vendimmarrës që mbikqyr dhe kontrollon veprimtarinë e universitetit që ka të bëjë me menaxhimin administrativ, financiar, ekonomik dhe të pronave të tij.

2. Funkcionet kryesore të Këshillit të Administrimit janë:

- a) Miraton kriteret për ndarjen e burimeve financiare;
- b) Miraton me kërkesën e Senatit Akademik projektbuxhetin me 2/3 e votave;
- c) Vlerëson efikasitetin e përdorimit të fondeve nga buxheti i shtetit ose burime të tjera të ligjshme dhe publikon rezultatet e vlerësimit;

- d) Me propozim të Rektoratit, miraton strukturën dhe numrin e personelit për të gjitha nivelet;
- e) Vlerëson planin e zhvillimit të universitetit dhe programin vjetor të veprimtarive të tij;
- f) Miraton shpërblimin e komisioneve të krijuara nga Senati Akademik dhe Rekorati me propozimin e këtyre të fundit;
- g) Miraton rregulloren e brendshme për administrimin, financat dhe kontabilitetin;
- h) Miraton rregulloren e funksionimit të tij.

3. Këshilli i Administrimit përbëhet nga:

- a) Një përfaqësues për çdo njësi kryesore;
- b) Një anëtar përfaqësues i studentëve;
- c) Një më pak se gjysma e anëtarëve të KADM-it, janë përfaqësues të cilët emërohen dhe shkarkohen nga Ministri i Arsimit dhe Shkencës.

4. Anëtarët e Këshillit të Administrimit zgjidhen nga njësitë përkatëse me votim të fshehtë në përputhje me rregulloren e zgjedhjeve. Anëtarësia në Këshillin e Administrimit është e papajtueshme me detyrën e anëtarit të Senatit Akademik, të zëvendësrektorit, dekanit, zëvendësdekanit.

5. Mandati i anëtarëve të Këshillit të Administrimit është 4-vjeçar. Mandati i anëtarit të Këshillit të Administrimit merr fund:

- a) Me mbarimin e afatit të mandatit;
- b) Kur jep dorëheqjen;
- c) Me shkëputjen e marrëdhënieve të punës me universitetin përpara përfundimit të mandatit;
- d) Kur mungon pa arsye në 3 (tre) seanca të njëpasnjëshme mbledhjesh të Këshillit të Administrimit;
- e) Kur dënohet me vendim gjyqësor të formës së prerë.

Në këtë rast bëhet zëvendësimi i anëtarit të larguar me anë të zgjedhjeve të reja, të shpallura nga rektori, brenda dy javëve, në njësinë që përfaqëson anëtari i larguar.

6. Këshilli i Administrimit mbledhet në seanca të zakonshme dy herë në tre muaj. Në mbledhjen e tij të parë Këshilli i Administrimit zgjedh kryetarin e tij dhe vendos mënyrën e organizimit. Këshilli i Administrimit mund të mbledhet edhe në seanca të jashtëzakonshme kur kjo kërkohet nga ½ e anëtarëve të tij.

Neni 12

Këshilli i Etikës

1. Këshilli i Etikës është organ kolegjal i cili diskuton probleme të etikës së jetës akademike dhe i paraqet propozime Rektorit për këto çështje.

2. Këshilli i Etikës përbëhet nga 5 anëtarë të stafit akademik që kanë së paku titullin Lektor. Ata përzgjidhen nga Senati Akademik.
3. Këshilli i Etikës mblidhet çdo dy muaj ose në raste emergjente me kërkesë të Rektorit. Pasi shqyrton çështjen në fjalë i bën propozime Senatit Akademik për të vendosur mbi masat përkatëse.
4. Rregullorja e funksionimit të Këshillit të Etikës miratohet nga Senati Akademik.

Neni 13

Rektorati

1. Rektorati është organ kolegjal ekzekutiv, që përbëhet nga:
 - a) Rektori;
 - b) Zëvendësrektorët;
 - c) Dekani i çdo fakulteti dhe njësie tjetër kryesore;
 - d) Kancelari i institucionit.

Rektorati kryesohet nga rektori.

2. Funksionet kryesore të Rektoratit janë:

- a) Harton planin disavjeçar të zhvillimit të institucionit;
- b) Harton programin vjetor të veprimtarive, si dhe ndjek zbatimin e tij pas miratimit në Senatin Akademik;
- c) Formulon kriteret për shpërndarjen e burimeve financiare, materiale dhe njerëzore;
- d) Parashtron përparësitë mes kërkesave për financime mes njësive kryesore të institucionit; harton dhe propozon projektbuxhetin për miratim në Senatin Akademik;
- e) Harton planin për investime, kontratat dhe marrëveshjet, që janë kompetencë e tij;
- f) Paraqet rekomandime për projektet për programet e studimeve, të kërkimit shkencor dhe ndryshimet e nevojshme strukturore për realizimin e tyre;
- g) Zbaton të gjitha vendimet e miratuara nga Senati Akademik dhe Këshilli i Administrimit;
- h) Monitoron dhe publikon rezultatet e vlerësimit të veprimtarive të institucionit;
- i) Përgatit marrëveshjen ndërmjet universitetit dhe Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës për rregullat e financimit;
- j) Propozon strukturën e përgjithshme dhe numrin e personelit të institucionit për të gjitha nivelet;
- k) Në përputhje me legjislacionin në fuqi merr masa për shpalljen vendeve të lira të punës, organizimin e konkurseve dhe përzgjedhjen e kandidatave sipas rregullores së Universitetit;
- l) Përgatit rregulloren e tij të punës, që miratohet nga Senati Akademik.

3. Rektorati kërkon mendimin e Senatit Akademik dhe të Këshillit të Administrimit për aspekte të funksioneve të këtyre të fundit.

4. Rektorati raporton një herë në semestër në Senatin Akademik dhe në Këshillin e Administrimit.
5. Rektorati harton raportin vjetor të veprimtarisë mësimore-kërkimore dhe financiare dhe ia paraqet atë për miratim Senatit Akademik dhe Këshillit të Administrimit brenda datës 20 dhjetor të çdo viti.
6. Rektorati ka të drejtë t'ia delegojë kompetencat personelit apo organit tjetër të institucionit, në përputhje me rregulloren e tij.
7. Si rregull Rektorati mblidhet një herë në javë gjatë periudhës mësimore. Mbledhjet e Rektoratit thirren dhe kryesohen nga rektori. Vendimet e Rektoratit merren me shumicë votash.
8. Në rregulloren e brendshme të studimeve të Universitetit “Aleksandër Moisiu” përcaktohen në mënyrë të hollësishme të drejtat dhe detyrat e Rektoratit, si dhe funksionimi i tij.

Neni 14

Rektori

1. Rektori është autoriteti drejtues i universitetit i cili vepron në emër dhe për llogari të tij. Rektori zgjidhet me votim të fshehtë nga i gjithë personeli akademik, joakademik, studentët dhe emërohet nga Presidenti i Republikës, duke u bazuar në dispozitat ligjore në fuqi dhe në Rregulloren e Zgjedhjeve të miratuar nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës. Në rast zgjedhjeje rektor i një kandidature e cila nuk është personel efektiv, ai automatikisht bëhet personel efektiv. Kandidatët për rektor duhet zotërojnë titullin “Profesor”, “Profesor i Asociuar” ose gradën shkencore “Doktor” (Ph.D), të fituar pranë universiteteve perëndimore dhe me përvojë akademike në këto universitete.
2. Rektori ka mandat 4-vjeçar.
3. Funksionet e Rektorit janë:
 - a) Drejton dhe përfaqëson Universitetin “Aleksandër Moisiu”, Durrës;
 - b) Nënshkruan marrëveshjet apo protokollet e bashkëpunimit me të tretët të cilat më parë janë ratifikuar nga Senatit Akademik;
 - c) Nënshkruan në emër të universitetit dokumentacionin e anëtarësimit të universitetit në shoqata kombëtare dhe ndërkombëtare të arsimit të lartë ose të tjera, dokumentacionin e bashkëpunimit me fondacione vendase e të huaja që ndihmojnë në zhvillimin e arsimit të lartë me kusht që për to të ketë vendosur Senati Akademik;
 - d) Vendos për bashkëpunimin e universitetit me shkollat e larta të vendit dhe të huaja, për shkëmbim përvoja dhe bashkëpunim në procesin mësimor-shkencor si dhe për kualifikimin e personelit;

- e) Shpall datën e votimit për zgjedhjen e organeve dhe autoriteteve drejtuese të universitetit dhe Këshillat e Studentëve sipas dispozitave ligjore në fuqi dhe Rregullores së Zgjedhjeve, si dhe emëron Dekanët e zgjedhur;
- f) Është anëtar i Konferencës së Rektorëve;
- g) Miraton zgjedhjen dhe emëron personelin akademik, kryetarët e degëve dhe qendrave, specialistët e lartë në universitet, duke iu përmbajtur kritereve të përcaktuara nga ky Statut dhe legjislacioni në fuqi;
- h) Deleton sipas shkallës hierarkike zbritëse menaxhimin e punonjësve të emëruar deri në marrjen e masave ndëshkimore në përputhje me legjislacionin në fuqi;
- i) Miraton strukturën e vitit akademik në shkallë universiteti në përputhje me udhëzimet e Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës;
- j) Autorizon hyrjen e forcave të rendit në mjediset e universitetit dhe i bën thirrje këtyre forcave në rast nevojë;
- k) Ka të drejtën e delegimit të firmës personave në varësi të tij dhe të drejtën e delegimit të kompetencave të tij zëvendës rektorëve;
- l) Rektori rezervon të drejtën për të kthyer për rishqyrtim vendimet e dekanit, të Këshillit të Fakulteteve kur ato bien ndesh me aktet ligjore e nënligjore në fuqi, me këtë Statut, Rregullore dhe vendimet e Senatit Akademik;
- m) Emëron dhe shkarkon zëvendësrektorët pas miratimit të kandidaturave të propozuara prej tij në Senatin Akademik;
- n) Nënshkruan diplomat e përfundimit të studimeve universitare si dhe dëshmitë e kurseve të ngritura pranë universitetit, pa pasur të drejtën e delegimit të firmës personave të tjerë;
- o) Miraton transferimin e studentëve të universitetit në universitete të tjera dhe anasjelltas sipas propozimit të dekanëve të fakulteteve, si dhe kërkesat e studentëve për plotësimin e studimeve në të njëjtin program studimi apo profil kur ka ndryshime në kreditet e studimeve në përputhje me kreditet e parashikuara në parimet e Procesit të Bolonjës, udhëzimet e Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës dhe aktet e tjera ligjore dhe nënligjore në fuqi;
- p) Ngre komisione e grupe pune me detyra të veçanta për çështje, studime e veprimtari të ndryshme;
- q) Ka të drejtën e ushtrimit të kompetencave të tjera të pashprehura me sipër dhe që nuk janë kompetencë e organeve apo autoriteteve të tjera drejtuese të universitetit;
- r) Miraton në mënyrë përfundimtare strukturën dhe numrin e përgjithshëm të personelit për të gjitha nivelet pas miratimit nga Këshilli i Administrimit.

4. Rektori largohet nga detyra:

- a) Kur merr fund mandati;
- b) Kur jep dorëheqjen;
- c) Kur dënohet me vendim gjyqësor të formës së prerë;

d) Kur largohet nga puna në kundërshtim me dispozitat ligjore në fuqi.

5. Në rast dorëheqjeje nga rektori ose pamundësie për të përfunduar mandatin Ministri i Arsimit dhe Shkencës shpall zgjedhje të reja sipas legjislacionit në fuqi dhe Rregullores së Zgjedhjeve.

6. Deri në zgjedhjen dhe emërimin e rektorit të ri, funksionet dhe kompetencat e tij i merr përsipër një nga zëvendësrektorët i ngarkuar nga Ministri i Arsimit dhe Shkencës.

Neni 15

Zëvendësrektorët

1. Zëvendësrektorët emërohen dhe shkarkohen nga rektori pas miratimit të kandidaturave të propozuara prej tij në Senatin Akademik.

2. Në mungesë të rektorit, zëvendësrektorët sigurojnë drejtimin ad-interim të universitetit sipas përcaktimeve të këtij Statuti.

3. Kompetencat e zëvendësrektorëve :

- a) Ndjekin hartimin dhe zbatimin e planeve si dhe programeve mësimore e kërkimore-shkencore në fakultete dhe njësitë e tjera kryesore;
- b) Mbikqyrin punën për specializimin universitar, brenda dhe jashtë shtetit, të personelit akademik të universitetit;
- c) Mbikqyrin dërgimin e studentëve jashtë shtetit për kurse të plota ose të pjesëshme në përputhje me Strategjinë e Arsimit të Lartë dhe të institucionit për realizimin e projekteve ndërkombëtare dhe marrëveshjeve ndëruniversitare;
- d) Kontrollojnë organizimin dhe procedurat e pranimit të studentëve të rinj;
- e) Ndjekin bashkëpunimin e njësive të universitetit me institucione të tjera të arsimit të lartë vendase ose të huaja, me institucione të tjera kërkimore-shkencore vendase e të huaja, me fondacione, firma, ndërmarrje, etj.;
- f) Kontrollojnë dhe përgjithësojnë përvojën e fakulteteve, qendrave kërkimore-shkencore dhe njësive të tjera të universitetit për probleme të punës mësimore dhe kërkimore-shkencore dhe organizon vlerësimin e cilësisë në institucion nëpërmjet grupeve të punës që ngre fakulteti apo departamenti;
- g) Organizojnë studime për zhvillimin perspektiv të universitetit dhe ia paraqesin rektorit dhe Senatit Akademik;
- h) I paraqesin rektorit dhe Senatit Akademik projektet për strukturën organizative të universitetit dhe organikat analitike të fakulteteve, qendrave kërkimore dhe njësive të tjera mësimore-shkencore.

4. Zëvendësrektorët largohen nga detyra:

- a) Kur japin dorëheqjen;

- b) Kur largohet nga universiteti përpara përfundimit të mandatit;
- c) Me propozim të rektorit dhe miratim të Senatit Akademik;
- d) Kur dënohen me vendim gjyqësor të formës së prerë;
- e) Kur largohet nga puna në kundërshtim me dispozitat ligjore në fuqi.

5. Në rast dorëheqjeje të zëvendësrektoreve ose pamundësie për të përfunduar mandatin, rektori propozon kandidaturat sipas këtij statuti.

Neni 16

Organizimi i Administratës

1. Administrata sipas natyrës dhe funksioneve organizohet në departamente, degë dhe sektorë. Krijimi i degeve, departamenteve dhe sektorëve propozohet nga kancelari. Propozimi diskutohet në Rektorat dhe miratohet nga Këshilli i Administrimit.
2. Struktura e organizimit të administratës dhe numri i punonjësve miratohen nga rektori.

Neni 17

Kancelari

1. Kancelari i universitetit është një nga autoritetet e tjera të universitetit, përgjegjës për drejtimin e përditshëm, administrativ dhe financiar të institucionit, për zbatimin e buxhetit, për mbikqyrjen dhe kontrollin e veprimeve financiare si dhe zbatimin e ligjshmërisë në universitet.
2. Kandidatura për kancelar përzgjidhet nëpërmjet konkursit të hapur nga Këshilli i Administrimit sipas dispozitave ligjore në fuqi. Rektori ia paraqet kandidaturën e përzgjedhur Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës për miratim. Kancelari emërohet nga Ministri i Arsimit dhe Shkencës. Kancelari duhet të ketë formim të lartë ekonomik apo juridik dhe së paku 5 vjet përvojë pune.
3. Kancelari i universitetit përgjigjet përpara Senatit Akademik, Këshillit të Administrimit, institucioneve qëndrore dhe organeve shtetërore të kontrollit, për zbatimin e akteve ligjore dhe nënligjore në fushën ekonomiko-financiare.
4. Funksionet e Kancelarit:
 - a) Ndjek drejtpërsëdrejti gjithë veprimtarinë ekonomiko-administrative në shkallë institucioni;
 - b) Organizon dhe kontrollon punën për zbatimin e buxhetit;
 - c) Organizon kryerjen e studimeve për zhvillimin perspektiv të universitetit në fushat që mbulon dhe ia paraqet Senatit Akademik dhe Këshillit të Administrimit;
 - d) Organizon dhe kontrollon kryerjen e kontroll-revizionimit financiar;

- e) Organizon dhe drejton kryerjen e shërbimeve ndaj të tretëve në universitet;
- f) Harton projektet për strukturat organizative dhe organikat analitike të të gjitha njësive administrative vartëse në universitet si dhe projektet për drejtimin administrativ të tij;
- g) Këshillon përgjegjësit e njësive strukturore të universitetit në shkallë institucioni, fakulteti, qendre kërkimore, degë shërbimi, departamenti, apo njësie më të vogël të parashikuar nga dispozitat e këtij Statuti në lidhje me hartimin e projekt-fondeve dhe pas miratimit nga Këshilli i Administrimit dhe Senati Akademik për administrimin e tyre të pavarur në përputhje me legjislacionin në fuqi;
- h) Përfaqëson universitetin si firmë e parë e deleguar nga rektori në marrëdhëniet financiare me institucionet financiare dhe në të gjitha marrëdhëniet kontraktore me të tretët, në fushat që mbulon;
- i) Thërret në raport dhe merr masa disiplinore për personelin administrativ që ka në varësi të drejtpërdrejtë, në përputhje me rregulloren e universitetit dhe dispozitat ligjore në fuqi;
- j) Ka të drejtë të ndjekë të gjitha çështjet gjyqësore në të cilat universiteti është palë.

KREU III

Organet Drejtuese të Fakulteteve dhe Njësive Kryesore

Neni 18

1. Fakultetet e Universitetit “Aleksandër Moisiu”, Durrës janë njësi kryesore, që bashkërendojnë mësimdhënien, kërkimin shkencor dhe zhvillimin profesional në fusha mësimore kërkimore të përafërta ose të ndërthurura.
2. Fakultetet ofrojnë programe studimi të llojeve dhe niveleve të ndryshme në përfundim të të cilave jepet diploma korespondente në përputhje me legjislacionin në fuqi.
3. Hapja dhe mbyllja e programeve të studimeve të të gjitha cikleve, riorganizimi dhe mbyllja e tyre bëhen me urdhër të Ministrisë të Arsimit dhe Shkencës, në bazë të kërkesës së universitetit.
4. Fakultetet organizohen në departamente. Çdo fakultet ka jo më pak se dy departamente.
5. Hapja dhe mbyllja e departamenteve bëhet me propozim të Këshillit të Fakultetit dhe miratim të Senatit Akademik.
6. Mënyra e funksionimit të fakultetit dhe njësive bazë përcaktohet në rregulloren e fakultetit.

Neni 19

Këshilli i Fakultetit ose i Njesisë Kryesore

1. Këshilli i Fakultetit ose i njësisë kryesore është organ kolegjal vendimmarrës, që programon, përcakton, në bazë të propozimeve të departamenteve, përdorimin e burimeve

njerëzore dhe materiale në dispozicion të fakultetit. Ai propozon programe të reja studimi ose kërkimi shkencor; për hapjen, ndryshimin ose mbylljen e departamenteve ose njësive të tjera, merr vendime për problemet financiare të fakultetit, në përputhje me autoritetin që i është deleguar atij, shqyrton dhe miraton raportin vjetor të dekanit për veprimtarinë mësimore dhe kërkimin shkencor. Këshilli i Fakultetit është një organ i zgjedhur, i cili vendos për problemet më të rëndësishme në fushën e mësimin, kërkimit shkencor dhe shërbimeve dhe i propozon Senatit Akademik planin strategjik të zhvillimit të fakultetit dhe mbikqyr zbatimin e tij. Këshilli i Fakultetit shqyrton dhe miraton në një mbledhje të hapur për personelin akademik, administrativ dhe për studentët, raportin vjetor të dekanit për veprimtarinë mësimore, kërkimore dhe financiare të fakultetit.

2. Këshilli i Fakultetit përbëhet prej përfaqësuesve të personelit akademik, ndihmës mësimor-shkencor dhe të studentëve të zgjedhur nga departamentet dhe njësitë e tjera strukturore të fakultetit ose institucionit të arsimit të lartë. Përbërja e tij, përfaqësitë e kategorive të ndryshme dhe mënyra e zgjedhjes përcaktohen në Rregulloren e Zgjedhjeve dhe dispozitat e veçanta për zgjedhjet në universitet. Përfaqësimi i studentëve bëhet sipas Rregullores së Zgjedhjeve.

3. Mandati i Këshillit të Fakultetit ose njësisë kryesore është 4-vjeçar. Mandati i anëtarit të këshillit është i njëjtë sipas rasteve të parashikuara për mandatin e anëtarit të Senatit Akademik në këtë Statut. Këshilli i Fakultetit kryen veprimtarinë e tij në përputhje me rregulloret e brendshme përkatëse ku përcaktohen mënyrat e mbledhjes, votimi e gjithçka tjetër që ka të bëjë me to.

4. Kryetar i Këshillit të Fakultetit ose njësisë kryesore është përkatësisht dekani ose drejtori.

5. Kompetencat e Këshillit të Fakultetit ose njësisë kryesore:

- a) I propozon Senatit Akademik drejtimet e zhvillimit në perspektivë të Fakultetit ose njësisë kryesore;
- b) I propozon Senatit Akademik vendosjen e lidhjeve me shkolla të larta të vendit e të huaja, si dhe anëtarësimin e fakultetit ose njësisë kryesore ose njësive të tyre në shoqata kombëtare e ndërkombetare ose fondacione e institucione të tjera që shfaqin interes për procesin mësimor e shkencor;
- c) Shqyrton kërkesat e departamenteve për programe të reja studimi, si dhe për hapje, ndryshime apo mbyllje departamentesh ose njësish të reja dhe pas miratimit i propozon Senatit Akademik vlerësimin dhe miratimin e tyre;
- d) Shqyrton Rregulloren e brendshme të fakultetit ose njësisë kryesore dhe ia propozon Senatit Akademik për miratim;
- e) Shqyrton planet mësimore të programeve të studimit të fakultetit ose njësisë kryesore dhe ia propozon Senatit Akademik për miratim;
- f) Shqyrton programet mësimore të kurseve afatshkurtra universitare dhe ia propozon Senatit Akademik për miratim sipas propozimeve të departamenteve;
- g) Miraton planin e punës shkencore të fakultetit ose njësisë kryesore të hartuar sipas propozimeve të departamenteve, qendrave kërkimore dhe njësive të tjera përbërëse

Neni 20

Këshilli i Profesorëve

1. Këshilli i Profesorëve është organ kolegjal për organizimin, drejtimin dhe ndjekjen e kualifikimit shkencor dhe pedagogjik në fakultetet apo njësisë kryesore të cilët ofrojnë programe studimi të ciklit të tretë. Këshilli i Profesorëve mund të ngrihet dhe në nivel universiteti, kur njësitë kryesore nuk përmbushin numrin e nevojshëm të profesorëve me kohë të plotë
2. Anëtarë të Këshillit të Profesorëve janë të gjithë anëtarët e personelit akademik me titullin “Profesor”.
3. Numri minimal i anëtarëve të Këshillit të Profesorëve është shtatë. Në rast se ky numër nuk plotësohet me anëtarë të brendshëm, anëtarë të këtij këshilli mund të jenë edhe personeli akademik me titull “Profesor i Asociuar” të cilët janë në kërkim të titullit “Profesor”, ose “Profesorë” të fushave të përafërta, të ftuar ose me kontratë.
4. Këshilli i Profesorëve drejtohet me rotacion për një vit akademik dhe funksionimi i tij rregullohet me rregullore të brendshme.
5. Kompetencat e Këshillit të Profesorëve janë:
 - a) Shqyrton dhe miraton kërkesat për tituj shkencor;
 - b) Sipas gradave dhe legjislacionit në fuqi, përcakton numrin e studentëve që mund të udhëheqë gjithsecili nga anëtarët e personelit akademik;
 - c) Miraton kriteret e pranimit në doktoratura dhe i publikon ato një vit akademik përpara fillimit të programit;
 - d) Miraton dhe lejon për mbrojtje doktoraturat e realizuara.
6. Këshillat e Profesorëve ngrihen dhe në fakultetet të cilat nuk kanë programe studimi të ciklit të tretë. Këto këshilla kanë të drejtë të shqyrtojnë dhe miratojnë kërkesat për kërkimin e titujve të personelit akademik dhe ia përcjellin për procedurë të mëtejshme fakulteteve që ofrojnë programet e studimeve të ciklit të tretë.

Neni 21

Dekani

1. Dekani është përkatësisht drejtues i fakultetit ose njësisë kryesore dhe zgjidhet me votim të fshehtë nga i gjithë personeli akademik, personeli joakademik dhe studentët e fakultetit/institutit të kërkimit dhe të zhvillimit/kolegjit profesional dhe emërohet nga Rektori. Në rast zgjedhjeje të një dekani i cili nuk është personel efektiv, në momentin e zgjedhjes pasojat ekonomike të shtesës në personel përballohen nga universiteti deri në akordimin e buxhetit përkatës, pasi të jenë miratuar procedurat e konkurimit dhe emërimit.

Dekani caktohet në detyrë për një mandat 4-vjeçar dhe duhet të ketë të paktën titullin “Profesor i asociuar” ose gradën shkencore “Doktor” (“Ph.D”) të fituar pranë universiteteve perëndimore dhe me përvojë akademike në këto universitete.

2. Dekani emërohen nga rektori në rastet e hapjes rishtas të fakultetit ose njësisë kryesore ose në rastin e moszgjedhjes së dekanit me proces zgjedhor.

3. Funksionet e dekanit të fakultetit të njësisë kryesore janë:

- a) Drejton dhe kontrollon gjithë punën mësimore-shkencore në fakultet ose në njësinë kryesore;
- b) Emëron përgjegjësit e departamenteve;
- c) Emëron zëvendësdekanët e fakultetit ose të njësisë kryesore, pas miratimit të kandidaturave në këshillin e fakultetit / njësisë kryesore;
- d) Interpreton dhe zbaton politikën e zhvillimit të universitetit në fakultetin ose njësisë kryesore përkatëse;
- e) Drejton përgatitjen e rregulloreve të brendshme të njësive përbërëse të fakultetit ose njësisë kryesore;
- f) Organizon dhe drejton punën për hartimin e planeve mësimore të programeve studimore të fakultetit ose njësisë kryesore;
- g) Në bazë të propozimit të këshillit të fakultetit ose përgjegjësit të njësive përbërëse miraton programet mësimore dhe planet kërkimore të secilit anëtar të personelit akademik të fakultetit ose njësisë kryesore;
- h) Ka autoritet mbi të gjithë personelin akademik, ndihmës mësimor-shkencor e administrativ, si dhe mbi studentët e fakultetit ose njësisë kryesore;
- i) Lidh dhe mbikqyr marrëveshjen për organizimin e kohës vjetore të punës për personelin akademik në varësi sipas dispozitave ligjore në fuqi;
- j) Ushtron kontroll për cilësinë e mësimdhënies, kërkimit shkencor si dhe çdo detyrë tjetër nga njësitë bazë;
- k) Drejton dhe organizon programet pasuniversitare në fushat që mbulon fakulteti ose njësia kryesore;
- l) I propozon Rektoratit aktivizimin e personelit të jashtëm mësimor-shkencor sipas nevojave të fakultetit përkatës;
- m) Vendos për masat disiplinore ndaj studentëve të fakultetit përkatës. Në raste të veçanta i propozon Senatit Akademik masën e përjashtimit për një vit ose përgjithmonë nga universiteti;
- n) Thërret në raport dhe jep masa disiplinore ndaj vartësve në përputhje me Rregulloren e universitetit, fakultetit dhe dispozitat e legjislacionit në fuqi;

4. Në mungesë të dekanit ose drejtorit, njëri nga zëvendësdekanët, ose në pamundësi një anëtar i Këshillit të Fakultetit siguron drejtimin ad-interim të fakultetit ose njësisë kryesore sipas përcaktimeve të këtij Statuti dhe Rregullores së universitetit.

5. Përcaktimi i hollësishëm i detyrave të tjera të dekanit që rrjedhin nga ky Statut, caktimi i detyrave e kompetencave të zëvendësdekanëve, si dhe çdo gjë tjetër që ka të bëjë me ta, bëhet bazuar në rregulloren e fakultetit ose njësisë kryesore.

6. Dekani largohet nga detyra:

- a) Kur merr fund mandati;
- b) Kur jep dorëheqjen;
- c) Në rastet që parashikohet me dispozita ligjore dhe nënligjore;
- d) Kur dënohet me vendim gjyqësor të formës së prerë;
- f) Kur largohet nga puna në kundërshtim me dispozitat ligjore në fuqi.

7. Në rast dorëheqjeje të dekanit, ose pamundësie për të përfunduar mandatin, rektori thërret zgjedhje të reja sipas legjislacionit në fuqi dhe Rregullores së Zgjedhjeve.

8. Deri në zgjedhjen dhe emërimin e dekanit, funksionet dhe kompetencat e tij me urdhër të rektorit, i merr përsipër njëri nga zëvendësdekanët.

Neni 22

Departamenti

1. Departamenti është njësi bazë mësimore-shkencore. Objekti i mësimdhënies dhe kërkimit shkencor të departamentit përfshin disa disiplina të një shkence. Propozimi për hapjen dhe mbylljen e tyre bëhet me propozim të Këshillit të Fakultetit dhe miratim të Senatit Akademik. Departamentet duhet të ketë në përbërje të tij të paktën 7 anëtarë efektivë si personel akademik, ndër të cilët të paktën 3 duhet të jenë me grada dhe tituj. Në rast se këto kritere nuk plotësohen, u lihet një afat 5-vjçar

2. Përgjegjësi i departamentit është autoriteti më i lartë për departamentin. Ai zgjidhet me votim të fshehtë nga i gjithë personeli akademik respektiv, sipas procedurave dhe kritereve akademike të përcaktuara në Rregulloren e Zgjedhjeve dhe emërohet nga dekan.

3. Kompetencat e përgjegjësit të departamentit janë si më poshtë:

- a) Ndjek zbatimin e programeve mësimore;
- b) Evidenton aktivitetin shkencor të secilit anëtar të departamentit. Dokumentacioni përkatës vihet në dispozicion të departamentit;
- c) I propozon dekanit masat për shkeljet eventuale të disiplinës në punë;
- d) Harton dhe i paraqet këshillit të fakultetit për miratim programet mësimore;
- e) I propozon këshillit të fakultetit organizimin e grupeve mësimore dhe kërkimore;

- f) Organizon përzgjedhjen me konkurim dhe i propozon dekanit emërimin e titullarëve të grupeve mësimore e kërkimore;
- g) Funkzionet më të hollësishme të përgjegjësit të departamentit, trajtohen në rregulloren e fakultetit ose njësisë kryesore.

4. Përgjegjësi i departamentit largohet nga puna:

- a) Kur jep dorëheqjen;
- b) Kur i mbaron mandati;
- c) Kur shkel aktet ligjore e nënligjore, Statutin dhe Rregulloren e Universitetit “Aleksandër Moisiu”;
- d) Kur dënohet me vendim gjyqësor të formës së prerë;
- e) Kur largohet nga puna në kundërshtim me dispozitat ligjore në fuqi.

Deri në zgjedhjen dhe emërimin e përgjegjësit të ri, funksionet dhe kompetencat e tij me urdhër të dekanit i caktohen njërit nga anëtarëve të departamentit.

KREU IV

Financimi dhe veprimtaria ekonomike

Neni 23

1. Universiteti “Aleksandër Moisiu”, Durrës është institucion buxhetor dhe financohet nga shteti pa iu mohuar parimi i autonomisë financiare.
2. Universiteti është person juridik publik, buxheti i të cilit është zë më vehte në buxhetin e shtetit për arsimin.
3. Ndarjen e buxhetit sipas zërave e nënzërave, fakulteteve, njësive kryesore, qendrave kërkimore, degëve të shërbimit, departamenteve, dhe njësive të tjera strukturore më të vogla, me përjashtim të atyre që janë ndarë nga ligji, e miraton Senati Akademik dhe Këshilli i Administrimit.
4. Universiteti ka të drejtë të krijojë e të përdorë në mënyrë të pavarur të ardhura nga veprimtari kryesore e dytësore e nga bashkëveprimi me të tretët, vendas ose të huaj. Universiteti dhe njësitë e tij përbërëse mund të sigurojnë në mënyrë të pavarur përfitime financiare me anë të kurseve afatshkurtra mësimore në fusha të ndryshme ose studimeve dhe zbatimit të tyre për interes të të tretëve në bazë të legjislacionit në fuqi.
5. Studentëve të universitetit u akordohen bursa studimi sipas kriterëve të përcaktuara nga Këshilli i Ministrave. Për kategori të caktuara studentësh jepen shpërblime ose çmime për

rezultate të larta në studime ose kërkime shkencore sipas kritereve të përcaktuara nga Senati Akademik në përputhje me legjislacionin në fuqi.

6. Çështje të tjera që kanë lidhje me veçoritë e zbatimit të rregullave të kontabilitetit e të administrimit të vlerave materiale e monetare në universitet dhe njësitë e tij strukturore përcaktohen në rregulloren e universitetit në përputhje me legjislacionin përkatës.

KREU V

Studimet

Neni 24

1. Në Universitetin “Aleksandër Moisiu”, Durrës, format e studimeve janë me kohë të plotë me frekuentim të detyrueshëm, me kohë të pjesshme me frekuentim të detyrueshëm, si dhe në distancë. Pranimet bëhen me kuota të miratuara nga Këshilli i Ministrave.

2. Pranohen të ndjekin studimet në Universitetin “Aleksandër Moisiu” Durrës:

- a) Shtetasit shqiptarë që kanë përfunduar me sukses maturën shtetërore dhe që fitojnë të drejtën për tu regjistruar në programin e studimit përkatës mbi bazën e dispozitave ligjore në fuqi;
- b) Studentë shqiptarë të transferuar nga universitete ose shkolla të tjera të larta të vendit apo të huaja, me programe të njëjta ose të ngjashme studimi sipas udhëzimeve dhe kritereve të përcaktuara nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës;
- c) Shtetas të huaj të cilët plotësojnë kriteret e miratuara nga Këshilli i Ministrave apo të miratuara me marrëveshje qeveritare dypalëshe ose shumëpalëshe;
- d) Shtetas shqiptarë e të huaj që kanë përfunduar studimet e larta dhe kërkojnë të drejtën për të ndjekur studime të larta në një program studimi të dytë, duke përballuar koston e plotë të studimeve. Nga ky rregull përjashtohen studentët e shkëlqyer.

Neni 25

1. Universiteti “Aleksandër Moisiu”, Durrës pranon transferime studentësh nga universitete të tjera, në vite të ndërmjetme dhe lejon largimin e studentëve të tij për në universitete të tjera sipas procedurave të parashikuara në udhëzimet e Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës, aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi. Kriteret dhe procedurat e transferimeve përcaktohen në rregulloren e universitetit.

2. Studentët që kanë përfunduar një program studimi mund të ndjekin një program të dytë studimi. Kostoja e plotë e studimeve përballohet nga vetë studentët me përjashtim të studentëve me rezultate të shkëlqyera.

3. Numri i studenteve që pranohen në programe të dyta studimi nuk mund të jetë me shumë se 10 % e numrit të studentëve të vitit të parë.

4. Për njohjen dhe ekuivalentimin e diplomave ngrihet qendra për njohjen dhe ekuivalentimin e diplomave.
5. Qendra e njohjes dhe ekuivalentimit të diplomave bën krahasimin e programeve të studimit me programet që ofrohen në universitet, dhe merr vendim për njohjen dhe ekuivalentimin e plotë apo të pjesshëm të diplomave me diplomat që lëshohen në universitet.
6. Përbërja organizimi funksionimi i kësaj qendre si dhe kritere me të hollësishme përcaktohen në rregulloren e miratuar nga Senati Akademik.

Neni 26

1. Në Universitetin “Aleksandër Moisiu”, Durrës në përputhje me parimet e Procesit të Bolonjës, ofrohen studime universitare të ciklit të parë, të ciklit të dytë dhe të ciklit të tretë. Studimet universitare të ciklit të parë realizohen me 180 kredite evropiane (ECTS) dhe kohëzgjatja normale e tyre është 3 vite akademike. Në përfundim të programeve të ciklit të parë lëshohet diplomë universitare “Bachelor” në fushën e arsimit të kryer. Gjithashtu ofrohen edhe programe të studimeve që realizohen me 120 kredite me kohëzgjatje normale jo më pak se 2 vite akademike, në përfundim të të cilave lëshohet “Diplomë profesionale” në fushën e arsimit të kryer. Kohëzgjatja maksimale e programeve të studimit të ciklit të parë është dyfishi i kohëzgjatjes normale. Studimet e ciklit të dytë janë “Master i Shkencave” dhe “Master Profesional”. Programet e studimeve “Master i Shkencave” realizohen me 120 kredite dhe kohëzgjatja normale e tyre është dy vite akademike. Programet e studimeve “Master Profesional” realizohen me 60-90 kredite dhe kohëzgjatja normale e tyre është 1.5 (një vit e gjashtë muaj) vit akademik. Studimet e ciklit të tretë janë studime të doktoratës që zgjasin të paktën 3 vite akademike dhe përfshihen 60 kredite për studime të organizuara teorike. Në përfundim të programeve të studimeve të doktoratës lëshohet diploma për gradën shkencore “Doktor”
2. Në ciklin e parë të studimeve pranohen kandidatët të cilët kanë mbaruar me sukses Maturën Shtetërore. Për programe të veçanta të ciklit të parë të studimeve universiteti mund të përcaktojë kritere të cilat i paraqiten për miratim Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës një vit para hapjes së tyre. Kandidatët që vijnë nga jashtë shtetit pranohen në përputhje me kriteret dhe procedurat e miratuara në Statutin dhe Rregulloren e brendshme të Universitetit “Aleksandër Moisiu”.
3. Cikli i dytë dhe i tretë i studimeve universitare organizohen në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi. Organizimi dhe funksionimi i studimeve universitare në ciklin e dytë dhe të tretë përcaktohen me rregullore të veçantë. Vazhdimi i studimeve nga cikli i parë i studimeve në ciklin e dytë dhe të tretë të studimeve, realizohet vetëm, pasi studentët, në përfundim të çdo cikli studimi, plotësojnë kriteret dhe standartet e përcaktuara nga strukturat përkatëse akademike të Universitetit “Aleksandër Moisiu” Durrës. Në fund të programeve të ciklit të dytë dhe të tretë të studimeve, studentët duhet të japin edhe provimin e gjuhës angleze mbi bazën e testeve të njohura ndërkombëtare.
4. Senati Akademik me propozim të këshillave të fakulteteve mund të përcaktojë kritere të veçanta për pranimin në ciklin e dytë dhe të tretë (“Master Profesional”, “Master Shkencor”

dhe “Doktoraturë”). Në të gjitha rastet këto kritere duhet të bëhen publike përpara se studentët të fillojnë ciklin pasardhës të studimeve.

5. Në Universitetin “Aleksandër Moisiu” Durrës programet mësimore janë semestrale, me kontroll njohurish të vazhdueshëm ku përfshihet pjesëmarrja aktive e studentëve. Mënyra e organizimit të kontrollit të dijeve përcaktohet me rregullore të veçante nga fakultetet përkatëse.

6. Veprimtaria mësimore-shkencore zhvillohet mbi bazën e programeve të studimeve të hartuara dhe të miratuara nga Senati Akademik.

Neni 27

Me përfundimin e studimeve të larta në Universitetin “Aleksandër Moisiu”, Durrës fitohen diplomat e studimeve sipas cikleve dhe niveleve të përcaktuara me ligj.

Neni 28

1. Studentët që në përfundim të studimeve të plota kanë të gjitha kurset të vlerësuara me notën dhjetë fitojnë “Medalje të Artë” me certifikatën përkatëse; ata që kanë jo me pak se 80% të notave dhjeta e pjesën tjetër nënta, fitojnë certifikatën “Student i Shkëlqyer”.

2. Studentët që përfundojnë një vit me të gjitha notat dhjeta përfitojnë bursë për vitin pasardhës. Bursat përballohen nga vetë universiteti bazuar në legjisllacionin në fuqi.

3. Dorëzimi i diplomave bëhet me ceremoni në çdo fakultet ose njësi kryesore. Për studentët që fitojnë “Medalje të Artë” ose certifikatën “Student i Shkëlqyer”, ceremonia organizohet në rang universiteti dhe dorëzimi i diplomave bëhet personalisht nga Rektori, në prani të përfaqësuesve të Senatit Akademik, administratës dhe studentëve.

Neni 29

1. Sigurimi i cilësisë dhe akreditimi janë detyra specifike të Rektoratit i cili ngre Njësinë e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë. Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë ngrihet dhe në nivel fakulteti/njësie kryesore.

2. Në njësinë e brendshme përveç personelit akademik marrin pjesë dhe përfaqësues nga studentët dhe ekspertë të jashtëm.

3. Njësia vlerëson një herë në vit efikasitetin e veprimtarive, mësimore, kërkimore, administrative dhe financiare të universitetit.

4. Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë ka pavarësi operative dhe i vihen në dispozicion të gjitha të dhënat e universitetit.

5. Organizimi dhe funksionimi i Njësisë të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë përcaktohen me rregullore të veçantë të miratuar nga Senati Akademik.

KREU VI

Të Drejtat dhe Detyrat e Studentëve

Neni 30

1. Studenti e fiton cilësinë si i tillë me regjistrimin në universitet dhe e humbet me marrjen nga ana e tij të diplomës universitare, ose të dëshmisë së kualifikimit, me përjashtimin nga shkolla ose me nënshkrimin e kërkesës për ç' regjistrim nga universiteti.

2. Studentët kanë të drejtë:

- a) Të pajisen me kartën e studentit;
- b) Të ndjekin programin e studimit dhe të gjitha veprimtaritë e tjera mësimore të organizuara në përputhje me statusin e tyre;
- c) Të shprehin opinionin e tyre për cilësinë e mësimdhënies dhe punën e personelit akademik të universitetit;
- d) Të përdorin të gjitha instalimet e pajisjet për kryerjen e punës së tyre mësimore-shkencore, sipas programeve e rregulloreve përkatëse, të përdorin bibliotekat e mjediset sportive, kulturore e informative të universitetit;
- e) Të zgjedhin e të zgjidhen në këshillat e studentëve të fakulteteve përkatëse, në përputhje me përcaktimet e këtij Statuti;
- f) Të zgjedhin këshillat e studentëve të fakulteteve nga të cilat përftohet Këshilli i Studentëve të universitetit;
- g) Kur plotësojnë kushtet e përcaktuara nga Këshilli i Ministrave, të përfitojnë bursë studimi dhe shpërblime e çmime të veçanta për merita studimi e kërkimi shkencor që administrohen nga universiteti;
- h) Të organizohen në shoqata studentore jopolitike duke ju përmbajtur përcaktimeve të akteve ligjore e nënligjore përkatëse.

3. Detyrat e studentëve:

- a) Të zbatojnë detyrimet që rrjedhin nga ky Statut, Rregullorja e universitetit, rregulloret e brendshme të fakulteteve, si dhe çdo akt ligjor apo nënligjor për arsimin e lartë;
- b) Të zbatojnë të gjitha detyrimet që rrjedhin nga planet dhe programet mësimore;
- c) Të paguajë tarifën e shkollimit dhe të shërbimeve që ofron universiteti;
- d) Të respektojë kodin e etikës të miratuar nga Këshilli i Etikës;
- e) Të respektojë të drejtat e personelit akademik, ndihmës mësimor-shkencor, dhe administrativ si dhe të studentëve të tjerë.

4. Mosrespektimi nga ana e studentëve i detyrimeve të përcaktuara në këtë statut dhe në rregulloren e fakulteteve ndëshkohet me masa disiplinore të përcaktuara në rregulloret e fakulteteve.

Neni 31

1. Këshilli i Studentëve është një organizatë e pavarur e studentëve në universitet, i cili nuk zhvillon veprimtari politike dhe ekonomike. Qëllimi i tij është promovimi i pjesëmarrjes së studentëve dhe koordinimi i përfaqësimit të tyre në organet drejtuese të universitetit.
2. Këshilli i Studentëve shpreh mendime dhe propozime për të gjitha problemet me interes të përgjithshëm për universitetin, si programet e studimeve, rregulloret për veprimtari të mësimore, të drejtën për të studiuar dhe cilësinë e shërbimeve. Në të gjithë aktivitetin e tij mbështetet nga organet drejtuese të universitetit.
3. Këshilli i Studentëve përbëhet nga anëtarë, studentë të cilët zgjidhen çdo 2 vjet nga votat e drejtpërdrejta të studentëve dhe mbështeten në legjislacionin në fuqi. Pas organizimit të zgjedhjeve, Këshilli i Studentëve zgjedh kryetarin e tij si dhe vendos mbi strukturën, mënyrën e organizimit dhe funksionimit të tij.
4. Këshilli i Studentëve nuk mund të organizohet në struktura të tjera politike e jopolitike jashtë universitetit.

Neni 32

Regjistri i studentëve

1. Kryesekretaret e fakulteteve përpilojnë në formë elektronike dhe të shkruar Regjistrin e Studenteve.
2. Me regjistrimin përfundimtar në universitet, në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi, kryesekretaret gjenerojnë numrin unik të matrikullit për çdo student.
3. Regjistri hartohet në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi dhe mbahet në ruajtje të përherëshme.

KREU VII

Punësimi në Universitetin “Aleksandër Moisiu” Durrës

Neni 33

1. Personeli i Universitetit të Durrësit përbëhet nga:
 - a) Personeli akademik;
 - b) Personeli ndihmës mësimor-shkencor;
 - c) Personeli administrativ.

2. Përzgjedhja për personelin akademik, personel ndihmës mësimor shkencor dhe administrativ bëhet me konkurim të hapur sipas procedurave të parashikuara në Rregulloren e universitetit.
3. Kontratat e punës, për të gjithë personelin e universitetit, nënshkruhen nga Rektori, në bazë të këtij statuti dhe legjislacionit në fuqi.
4. Kontrata duhet të përmbajë përshkrimin e vendit të punës dhe detyrimet e personelit sipas legjislacionit në fuqi.
5. Për të plotësuar nevojat e procesit mësimor, këshillat e fakulteteve, me propozim të departamenteve, ftojnë për veprimtari mësimore e kërkimore personel akademik, sipas kërkesave të vendit të punës, për periudha semestrale ose njëvjeçare të përsëritshme. Përzgjedhja e personelit akademik të ftuar duhet të kombinojë nevojën e fakultetit apo njësisë për mësimdhënie ose kërkim shkencor me kualifikimet e tyre.
6. Për nevojat e procesit mësimor mund të aktivizohen me kontratë me një afat të caktuar punonjës mësimor-shkencorë të jashtëm. Kontrata nënshkruhet nga rektori në përputhje me legjislacionin në fuqi.
7. Universiteti “Aleksandër Moisiu” ka të drejtë të punësojë me kontratë personalitete, vendas apo të huaja, për periudha të shkurtra kohore. Ky personel punësohet me vendim të Senatit Akademik, sipas propozimeve të njësive kryesore të institucionit Kjo kategori punonjësish me kontratë është jashtë numrit të miratuar të punonjësve buxhetorë të universitetit.
8. Personeli akademik, administrativ dhe ndihmës mësimor gëzon të gjitha të drejtat dhe detyrimet e përcaktuara në aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi dhe të parashikuara në kontratën e lidhur ndërmjet tij dhe universitetit.
9. Përzgjedhja dhe rekrutimi i personelit akademik, administrativ dhe ndihmës mësimor, zhvillohet si më poshtë:
 - a) Departamentet dhe fakultetet përcaktojnë kriteret specifike për vendet e punës;
 - b) Publikohet njoftimi i konkursit për vendet e lira të punës, në formë të shkruar dhe elektronike;
 - c) Aplikimet pranohen vetëm me postë;
 - d) Vlerësimi i kandidaturave përfshin dy faza:
 1. Vlerësimi i dosjes;
 2. Intervista.
 - e) Dekanët në bashkëpunim me komisionet e vlersimit paraqesin rektorit kandidaturën e renditur e para në klasifikimi e kryer nga komisioni ad hoc i krijuar nga dekani.
 - f) Autoriteti drejtues i Universitetit lidh kontratë pune me kandidatin e përzgjedhur mbështetur në legjislacionin në fuqi.

Neni 34

Norma mësimore dhe mbingarkesa

1. Personeli akademik kryen veprimtari të mësimdhënies, kërkim shkencor ose të aplikuar, shërbime për zhvillimin e institucionit, konsultim dhe këshillim për studentët dhe detyra administrative.

2. Punonjësit e brendshëm të personelit akademik duhet të përmbushin detyrimet e tyre profesionale bazuar në legjislacionin në fuqi.

Neni 35

Kushtet e punës dhe të trajtimit

1. Në Universitetin “Aleksandër Moisiu”, Durrës koha javore normale e punës për të gjithë punonjësit është jo më pak se 40 orë, shpërndarë në 5 ditët të javës. Për personelin akademik koha konkrete caktohet në marrëveshjen për organizimin e kohës vjetore të punës.

2. Personelit akademik të brendshëm u jepet ngarkesë mbi normë vetëm në raste të veçanta kur ka emergjencë për nevojat e punës akademike dhe kur janë shfrytëzuar të gjitha mënyrat e tjera të mundshme në përputhje me aktet ligjore e nënligjore. Shpërblimi për punën mbi normë bëhet sipas akteve normative në fuqi.

3. Paga mujore dhe vjetore e punonjësve caktohet në përputhje me legjislacionin në fuqi.

4. Problemet e tjera lidhur me kohën e punës e të pushimit zgjidhen sipas legjislacionit në fuqi.

Neni 36

Masat Disiplinore

1. Autoritetet drejtuese të Universitetit “Aleksandër Moisiu”, Durrës marrin masa disiplinore në rastin e mosplotësimit të detyrave të parashikuara në kontratën e punës, mosrespektimit të urdhrave të titullarëve, për thyerje të disiplinës në punë si dhe për shkelje të rregullave të etikës të parashikuara në rregulloret përkatëse.

2. Llojet e masave disiplinore që marrin autoritetet drejtuese të universitetit në rastin shkeljes së dispozitës së mësipërme janë:

- a) Vërejtje me shkrim;
- b) Vërejtje me paralajmërim;
- c) Pezullim deri në një muaj për autoritetet drejtuese në varësi;
- d) Largim nga puna.

3. Masat disiplinore jepen nga titullari sipas një procedure administrative e cila garanton të drejtën për t’u informuar, për t’u dëgjuar, për t’u mbrojtur dhe për t’u ankuar. Titullari komunikon vendimin për marrjen e masës disiplinore në Degën e Burimeve Njerëzore. Dega e Burimeve Njerëzore i komunikon punëmarrësit konkret vendimin e titullarit për marrjen e masës disiplinore. Për çdo shkelje jepet vetëm një masë disiplinore. Nuk është e nevojshme të merren të gjitha masat disiplinore para se punëmarrësi të largohet nga puna.

4. Procedura e marrjes së masave disiplinore:

- a) Masa disiplinore ndërrmerret vetëm në rast se punëmarrësi ka kryer shkelje të ligjeve dhe të rregulloreve në fuqi;
- b) Ku për çdo shkelje bëhet një shkresë dhe një akt përkatës i shoqëruar me një paralajmërim verbal për marrjen e kësaj mase disiplinore;
- c) Masa disiplinore “Vërejtje me shkrim” merret vetëm në rast se punëmarrësit e personelit akademik ose administrativ nuk përmbushin një urdhër të titullarit të institucionit ose të eprorit direkt;
- d) Në rast se pas marrjes së masës së mësipërme disiplinore punëmarrësi vijon të shkelë urdhërat e punëdhënësit këtij të fundit i lind e drejta të marrë masën disiplinore “Vërejtje me Paralajmërim”;
- e) Në rast se mbas marrjes së masës disiplinore “Vërejtje me Paralajmërim” punëmarrësi sërish vijon të thyejë rregullat e disiplinës në punë, të mos respektojë urdhërat e punëdhënësit, detyrimet e kontratës si dhe rregullat e etikës punëdhënësi mund të kalojë në marrjen e masës disiplinore që është largim nga puna i punëmarrësit;
- f) Punëdhënësit i lind e drejta të marrë masën disiplinore të parashikuar në legjislacionin në fuqi, në rastet kur e shikon të përshtatshme dhe në përputhje me natyrën e shkeljes dhe është i detyruar ta revokojë këtë masë në rast kur kjo hidhet poshtë me vendim gjyqësor të formës së prerë.

5. Shlyerja e masave disiplinore.

Masat e mësipërme disiplinore mund të shlyhen, në qoftëse brenda 6 muajve nga dita e dhënies së tyre, ndaj punëmarrësit nuk është marrë ndonjë masë tjetër disiplinore. Masat disiplinore të shlyera hiqen nga dosja vetjake e punëmarrësit.

KREU VIII

Kodi etik

Neni 37

Në zbatim të Ligjit Nr. 9741, datë 21.05.2007 “ Për Arsimin e Lartë në Republikën e Shqipërisë “ i ndryshuar, duke respektuar të drejtat dhe liritë themelore të njeriut dhe laicitetin e institucioneve të arsimit të lartë, si dhe në përputhje me filozofinë e deklaruar të organizimit dhe funksionimit të Universitetit “Aleksandër Moisiu”, Durrës parashikohen rregullat e Kodit të Etikës, të detyrueshme për zbatim nga personeli akademik, ndihmës mësimor, administrativ si dhe nga studentët. Elementët përkatës të Kodit të Etikës përcaktohen nga Këshilli i Etikës dhe miratohet nga Senati Akademik.

KREU IX

Marrëdhëniet me jashtë

Neni 38

1. Universiteti “Aleksandër Moisiu”, Durrës ka të drejtën e vendosjes së marrëdhënieve me institucione të huaja dhe vendase të arsimit të lartë me qëllim shkëmbim përvoja akademike, bashkëpunimi në procesin mësimor, kualifikimi të personelit akademik dhe kërkimi shkencor pas miratimit paraprak në Senatin Akademik.
2. Universiteti ka të drejtën e anëtarësimit në shoqata e organizata ndërkombëtare të arsimit të lartë, si dhe të drejtën e pjesëmarrjes në programet ndërkombëtare të kërkimit shkencor.
3. Universiteti ka të drejtë të bashkëveprojë me organizma joqeveritare vendase dhe të huaja që ndihmojnë në zhvillimin e Arsimit të Lartë dhe të kërkimit shkencor.
4. Për këto aktivitete informohet Ministria e Arsimit dhe Shkencës.

KREU X

Kërkimi shkencor

Neni 39

1. Personeli akademik i universitetit si dhe studentët e ciklit të dytë dhe të tretë të studimeve kanë të drejtë të zhvillojnë aktivitet kërkimor shkencor për funksione të universitetit apo të institucioneve të tjera.
2. Veprimtaria kërkimore shkencore brenda universitetit planifikohet dhe mbështetet financiarisht në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi.
3. Kriteret për mbështetjen financiare miratohen nga Senati Akademik. Shpallja e konkurseve për mbështetje financiare bëhet në muajin nëntor dhe brenda muajit prill të vitit pasardhës bëhet shpallja e fituesve për financim të plotë apo të pjesshëm nga fondet e universitetit.
4. Staf i akademik veçmas apo në grup, ka të drejtën që pas miratimit nga ana e Rektoratit, të aplikojë për mbështetje apo financim nga organizmat shtetërore apo private për realizimin e projekteve kërkimore shkencore.
5. Në të gjitha rastet duhet të garantohet e drejta e autorësisë për personelin akademik dhe universitetin.
6. Aktivitetet kërkimore shkencore për llogari të të tretëve mund të realizohen kur plotësohen kushtet e mëposhtëme:
 - a) Nuk cënon përmbushjen e detyrimeve ndaj universitetit sipas kontratës së punës;
 - b) Nuk pengon punën kërkimore dhe shkencore në universitet.
7. Të ardhurat që krijohen nga aktiviteti kërkimor shkencor, për llogari të universitetit apo për institucione të tjera, përdoren sipas akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi duke synuar stimulimin e pjesëmarrësve në këto aktivitete.

Kualifikimi

Neni 40

Punonjësve të Universitetit “Aleksandër Moisiu”, Durrës u njihet e drejta e kualifikimit sipas dispozitave ligjore në fuqi.

Neni 41

Viti sabatik

1. Personeli akademik me tituj shkencor ka të drejtë që çdo 7 vjet, për periudha kohore deri në një vit, të punojë për përparimin e tij akademik në një sektor të fushës së tyre. Kjo kohë mund të konsumohet si e tërë ose me pjesë. Për këto raste personi i interesuar i paraqet kërkesë dhe mer miratim pranë Këshillit të Fakultetit. Autoritetet drejtuese të institucionit të arsimit të lartë nuk kanë të drejtë për vit sabatik gjatë kohës së ushtrimit të mandatit drejtues si drejtues, i zgjedhur apo i emëruar.

2. Personeli akademik që përfiton nga viti sabatik lidh kontratë me universitetin për të drejtat, detyrimet, dhe mënyrën e trajtimit financiar gjatë kësaj periudhe.

3. Gjatë kësaj periudhe personelit akademik nuk i ngarkohet detyrë mësimdhëniejeje. Personeli akademik mund të ndjekë gjatë këtij viti edhe kurse specializimi deri në tre muaj jashtë institucionit.

KREU XI

Vula zyrtare dhe Stema

Neni 42

1. Universiteti “Aleksandër Moisiu” Durrës, ka vulën zyrtare sipas modelit të miratuar nga Këshilli i Ministrave. Vula ka diametrin 30 mm, me stemën shtetërore në qendër dhe rreth saj në pjesën e lartme shënohet: “REPUBLIKA E SHQIPËRISE”, ndërsa në pjesën e poshtme “UNIVERSITETI “ALEKSANDER MOISIU”, DURRES” (sipas modelit 1 në faqet pasardhëse).

2. Universiteti i Durrësit ka për simbol të tij stemën e paraqitur nga modeli 2 në faqet pasardhëse. Fakultetet e veçanta miratojnë simbolet e tyre nisur nga ky model.

KREU XII

Dokumentacioni i Universitetit “Aleksandër Moisiu” dhe ruajtja e tij

Neni 43

Universiteti “Aleksandër Moisiu”, si institucion publik i arsimit të lartë me karakter mësimor e shkencor, ka për detyrë të sistemojë, të mirëmbajë dhe të ruajë dokumentacionin.

Neni 44

Universiteti “Aleksandër Moisiu”, mban në mënyrë të detyrueshme disa dokumente kryesore, në përputhje me legjislacionin në fuqi, dhe me ligjin për arkivat. Lista e dokumenteve, afatet e mënyrat e plotësimit të tyre, përcaktohen në rregulloret përkatëse të çdo njësie kryesore të institucionit.

KREU XIII

Dispozita të fundit

Neni 45

Funksionimi i Fakultetit të Studimeve të Integruara me Praktikën në periudhën kalimtare të përcaktuar në Vendimin e Këshillit të Ministrave për hapjen e tij, funksionon me status të veçantë në përputhje me këtë vendim.

Neni 46

Në përputhje me Ligjin Nr. 9741, datë 21.05.2007 “Për Arsimin e Lartë në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, dhe në përputhje me këtë Statut hartohet Rregullorja e Universitetit “Aleksandër Moisiu”, Durrës si dhe rregullat dhe akte të tjera në zbatim të këtij statuti.

Neni 47

Ky Statut u miratua me Vendimin Nr. 13, datë 24.03.2011, të Senatit Akademik të Universitetit “Aleksandër Moisiu” Durrës.